


REPUBLIKA E KOSOVËS
DEPARTAMENTI I TATIMIT NË PRONË
NË PRANA SHËRBI ADMINISTRATIVE



Doza e llogaritë
Nr. IV-09 Data 20.01.2022
Gr. _____
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić



Republika e Kosovës
Republika Kosovo- Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić

Data	18.01.2022
Për	z.Vlora Mjekiqi-Kabashi - Kryesuse e Kuvendit Komunal
Nga	z.Zarife Behluli - DEFZII
Lënda	Kërkesë për aprovimin e vendimit për Tatimin në Pronë

E nderuar

Me rekomandim të Departamentit të Tatimit në Pronë kërkojmë që për vitin 2022 të bëhet aprovimi i vendimit për normat tatimore për Tatimin mbi Pronën e Paluajtshme. Ju lutem të bëni aprovimin e vendimit për vitin 2022 në Kuvendin Komunal të Komunës .

Me respekt



Në mbështetje të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe të Ligjit Nr 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme dhe Nenit 83 pika 19 të Statutit të Kuvendit Komunal të Obiliqit Nr; I -34 të dt ;25.04.2016 Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Obiliqit propozon këtë:

PROPOZIM - VENDIM
Për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2022

Neni 1

Normat Tatimore

Në zbatim të Ligjit Nr. 06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 9, paragrafi 1, nën paragrafët 1.1 deri 1.9, Kuvendi Komunal i Komunës i Obiliqit cakton normat tatimore për vitin 2022 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë pronë publike, si vijon:

Kategoria e Pronës	Norma tatimore
Për njësitë bujqësore të parcelave	0.15 %
Për njësitë bujqësore të objekteve	0.15 %
Për njësitë pyjore të parcelave	0.15 %
Për njësitë rezidenciale të parcelave	0.15 %
Për njësitë rezidenciale të objekteve	0.15 %
Për njësitë komerciale të parcelave	0.25 %
Për njësitë komerciale të objekteve	0.25 %
Për njësitë industriale të parcelave	0.30 %
Për njësitë industriale të objekteve	0.30 %

Neni 2

Zbatimi

Në zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoja për Buxhet dhe Financa dhe Zyrja e Tatimit në Pronë

Neni 3

Ky vendim shfuqizon vendimin Nr.- I-120 të datës ;30, 09. 2020 për vitin 2021

Neni 4

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas miratimit nga ana e Kuvendit Komunal dhe do të fillojë së zbatuari nga 1 Janari 2022.

Vendimi Nr. _____

Kryesuese e Kuvendit
Vlora Mjekiqi Kabashi